



RAPORT – Gjurmimi i Banesave Tradicionale në Ansamblin Arkitektonik, Krahina e Shqerisë, Bënjë, Permet.

Raport i punës 6 mujore



Hartues:

Msc. Ark. Kreshnik Merxhani, Asoc. Prof. Dr. Ark. Edmond Manahasa



Hyrje

Ky raport paraqet një përmbledhje të punës së kryer në kuadër të evidentimit të objekteve me vlera kulturore, historike dhe arkitektonike në fshatin Bënjë të zonës së Përmetit. Puna është fokusuar në gjurmimin, dokumentimin dhe vlerësimin paraprak të ndërtimeve që përfaqësojnë tipologjinë ndërtimore të banesave fshatare të krahinave të Përmetit. Kjo trashëgiminë kulturore përtej rregjistrimit e dokumentimit me interes studimor ka për qëllim dhe propozime pas një vlerësimi përfundimtar për tju drejtuar institucioneve përgjegjëse që të hapin procesin për mbrojtje ligjore si monumente kulture.

Qëllimi i punës

Gjurmimi, studimi, dokumentimi dhe vlerësimi i objekteve që mbartin vlera historike, arkitektonike, urbanistike apo etnografike. Gjithashtu, puna në terren synon krijimin e një panorame të qartë të situatës së banesave në ambient rural mbi gjendjen e konservimit të tyre dhe vlerave të tyre si elementet e mabientit të ndërtuar që rruanë dhe paraqesin vlera dhe të cilat mund të propozohen që të listohen si monumente të kulturës.

Përshkrimi i veprimtarisë së kryer

Vizitat dhe hulumtime në fshatin : Bënjë

Kushtet e pa përshtatshme klimaterike dhe disa probleme me bllokimin e rrugëve e kufizuan punën kërkimore në terren vetëm në një nga 3 fshatrat e planifikuar për tu vizituar. Procesi ka përfshirë vëzhgim të drejtpërdrejtë të ndërtimeve tradicionale dhe ambientit të ndërtuar dhe peiazhistik që i rrethon. U realizua regjistrim të gjendjes së tyre aktuale, si dhe mbledhje informacioni nga banorë të zonës, të cilët kanë kontribuar me të dhëna mbi historikun dhe përdorimin e tyre ndër vite. Ndërtimet e spikatura nga kjo ekspeditë gjurmuese përfshijnë kryesisht ndërtesa tradicionale banimi, por dhe infrastrukturën tradicionale të fshatit si kalldrëmet, krojet etj. Kisha e fshatit Bënjë, e ruan tashmë statusin si monument kulture, është e studiuar, dokumentuar dhe restauruar dhe nuk u përfshi në këtë praktikë gjurmuese e vlerësuese. Areali ndërtimor dhe kulturor na jep një panoramë që reflektohet dhe te vet banesat.

Vështirësi dhe problematika


Gjatë realizimit të punës janë hasur disa vështirësi, kryesisht të lidhura me gjendjen fizike të dëmtuar të disa objekteve, mungesën e dokumentacionit historik të shkruar, si dhe ndërhyrjet e pakontrolluara që kanë ndikuar në humbjen e elementeve origjinale. Në disa raste, qasja në objekte ka qenë e kufizuar për shkak të përdorimit privat ose mungesës së mirëmbajtjes.

Rezultatet paraprake

Si rezultat i punës së kryer, është hartuar një listë paraprake e ndërtimeve me vlera kulturore, një pjesë e të cilave vlerësohen si të përshtatshme për t'u propozuar për marrjen e statusit Monument Kulture të kategorisë së Parë dhe të Dytë (Shiko harta bashkëngjitur). Këto ndërtime paraqesin interes të veçantë për shkak të nivelit të lartë të autenticitetit, përdorimit të teknikave tradicionale të ndërtimit, ruajtjes së elementeve origjinale, si dhe rolit të rëndësishëm që kanë pasur në jetën sociale dhe kulturore të komunitetit dhe për qëllim të ansamblit arkitekturor të fshatit.

1. Zonat e studiuarate arkitektures Rurale në vendin tonë

Në vendin tonë studimi i arkitekturës popullore qoftë të Banesës qoftë të tipologjive të tjera ka qenë në nivele të larta profesionale dhe shkencore të kryera nga vëzhgime e ekspedita periodike në terrën veçanërisht nga Instituti i Monumenteve të Kulturës që para e mandej pas themelimit të tij në 1965. Sot kemi studime të plota ku kuptojmë tipologjitë e ndryshme të banesave sipas rajoneve dhe situatave urbane apo rurale por për fat të keq këto studime u ndërprejnë dhe një pjesë e krahinave ende ngelen të pa njohura. Pikërisht këtë boshllëk kërkon të adresojë dhe ky projekt që ka aktivizuar disa universitete dhe organizma të specializuar dhe që ka mbështetjen e AKSHI. Përmeti, kjo krahinë e madhe etnografike është e pa studiuar në mënyrë të plotë. Për këtë krahinë kemi artikujt jo të drejtëpërdrejtë në lidhje me tipologjinë e arkitekturës së banesës apo me ansamblet arkitektonike. Nga hulumtimi ynë paraprak, gjetëm vetëm një artikull nga Gj. Frashëri mbi fshatin Odrichan por jo shumë i fokusuar te arkitektura dhe vlerat e saj e për më tepër ky fshat i ka humbur tashmë krejtësisht banesat tradicionale që ka patur. Një artikull i dytë për krahinën e Dëshnicës nga Faruk Zershati paraqet gjetjet e ekspeditave të viteve 70-të të shek XX, që u ndërprejnë dhe nuk e plotësuan dot panoramën e plotë të arkitekturës tradicionale të këtyre trevave. Më poshtë po paraqesim një hartë mbi gjendjen e studimeve në territorin ku flasim. Në këto kushte studimi dhe mbrojtja e hollësishme e Ansambli Arkitektonik tashmë të mbrojtur të fshatit Bënjë, përbën një hap të rëndësishëm si shkencor.



Fig, 1-2, Hartë e Shqipërisë që ilustron zonat e ngelura ende pa një studim të mirfilltë mbi arkitekturën e tyre (hartuar nga K. Merxhani 2015) . Figura 2, tregon hartën e pasurive materiale të Përmetit (vizatimi original punuar nga Aleks Todhe ndodhet në muzeun e Përmetit. Përpunimi grafik realizuar nga Velisa Beqiri dhe Klea Lala)

1. Ansambli Arkitektonik në fshatin Benjë, Përshkrimi arkitektoniko – ndërtimor dhe Historik.

Emri i fshatit Bënjë e ka origjinën e vet nga banjat termale pranë Urës së Katiut, që ndodhen afër fshatit, në lindje të tij, në të dyja anët e lumit Lengaricë. Këte prejardhje e dëshmojnë mjaft harta të vjetra topografike gjermane, austriake, sllave, ku gjejmë emërtimin “Bano e Cecerit” d. m.th. Bënja e Shqerisë. (krahinë në rrethin e Përmetit)

Fshati Bënjë ndodhet në lindje të Përmetit, rreth 10 km në vije të drejtë larg tij. Ai shtrihet në një teren të thyer, të rrethuar me shpate e kodra. Në të dy krahët fshatin e përshkrojnë dy përrenj: në të majte ai i Oskusheve dhe në djathtë përroi i Bënjës, të dy këta përrenj bashkohen në fund të fshatit dhe më andej derdhen në lumin e Lengaricës. Bënja kufizohet nga verilindja me fshatrat, Ogren, Vinjah, Okdunan e Grabovë. Nga veriperëndimi me fshatrat Lupcke e Novoselë, kurse nga jugu me përroin e Buharecit. Fshati Bënjë përmendet sipas defterit turk të Përmetit dhe Korçës i vitit 1431-1432 përkthyer nga Vexhi Buharaja, më 1969 në fq. 31 e 38 shënon një fshat me emrin Bano, Bane, pikërisht aty ku ndodhet Bënja. Ky fshat kishte asokohe “9 shtëpi dhe 548 akçe të ardhura” çka tregon se Bënja ka pasur banorët e saj autokton jo vetëm për periudhën që flasim por edhe me herët.

Bënja është një fshat tëresisht i gurtë, me shtëpi, çati, rrugë kalldrëme të ndërtuara të gjitha prej guri. Këto ndërtesa të gurta, të ngjeshura njëra pas tjetrës, ngrihen shkallë shkallë në një pllajë të pjerët kurriz peshku duke përbërë një ansambël të vetëm me pamjen e një kështjelle të gurtë.

Nisur nga godinat ekzistuese dhe gjurmët e rënojave mund të themi se Bënja ka patur rreth 40 shtëpi, që i ndan mes për mes rruga kryesore e fshatit, duke formuar dy lagje, atë të sipërme mbi rrugë dhe atë të poshtme nënë rrugë. Të gjitha rrugët e fshatit kanë qënë të shtruara me kalldrëm me gurrë lumi me një formë të tillë që të rridhnin lehtësisht ujrën e shiut. Për gjerësinë e tyre është patur parasysh kalimi i kafshëve me ngarkesë. Rruga me kalldrëm zgjatet në gjithë gjatësinë deri poshtë fshatit tek ura e gurtë mbi përroin e Bënjës.

Në hyrje të fshatit, ndodhet kisha e Shën Marisë së Bënjës e ndërtuar në vendin e së vjetrës në vitin 1879 përrurimi i së cilës është bërë më 7 qershor 1891. Kjo kishë është ndër më madhështoret në trevën e Përmetit dhe shpreh teknikën e lartë të realizimit të saj, gjithashtu ajo shquhet edhe për nivelin e lartë artistik të ikonostasit realizuar nga mjeshti Sionidhis Qioni të përfunduar në vitin 1904. Në oborrin e kishës para derës në anën perëndimore të kishës ndodhet një pus i mbyllur uji, i cili shërbente për të pirë si dhe për shërbesat fetare. Po brënda oborrit të kishës në anën perëndimore të saj, ndodhet godina e shkollës së fshatit, një ndërtesë dy katëshe prej guri gri dhe të mbuluara me rrasa guri të zi. Kjo kishë është “Monument Kulture” e kategorisë së parë. Fshati gjithashtu ka katër lëmenj të rrethuara me mur dhe të shtruara me pllaka gurri, dy prej tyre ndodhen në pjesën e sipërme të fshatit dhe dy në atë të poshtmen. Rreth 300m në perëndim të fshatit, midis përroit të Kallogjerit dhe të Priftit ndodhet “Gurrëza e fshatit” i vetmi burim që ka furnizuar me ujë të pijshëm banorët e Bënjës. Ajo ka një mur të gurtë rreth dy metra të lartë dhe katër metra të gjerë, që formonte përsipër një pezull të sheshtë. Poshtë tij, në

mes të murit është vendosur kupa e gurrit për rrjedhjen e ujit. Në të dy krahët e saj janë ndërtuar dy sofate, që kanë shërbyer për çlodhje dhe për të vendosur bucelat e ujit.

Veçori dalluese e Bënjës është se të gjitha shtëpите janë të grrumbulluara në një vend të vetëm, duke qënë pothuajse vazhdim i njëra tjetrës, madje disa janë aq afër njëra tjetrës, sa të japin përshtypjen e një ndertese të vetme. Shumica e shtëpive janë dy katëshe kurse tre-katër prej tyre tre katëshe. Për tu theksuar është planimetria interesante e ndërtimit, përshtatja e përsosur që i është bërë terrenit apo caktimit të vendit të ndërtimit në raport me njëri tjetrin, për të ruajtur harmoninë urbanistike.

Shtëpitë e Bënjës kanë dhoma të bollëshme e të larmishme, me dritare të mëdha e të shumta të paisura me hekura e kanate druri të punuara bukur, si dhe me dyer të siguruar mirë. Ndërtesa në katin e parë kish hajatet, të shtruara me pllaka guri, *bodrumet* dhe *patet* e bagëtive e të kafshëve të samarit. Ndërtesa në katin e sipërm në disa raste ruajnë ambientin e quajtur *divan*, si dhe *odat* e pritjes, dhomat e dimrit, *manxatot*, dhomat e fjetjes, *magjirotë* e gatimit e ngrënies, *qilarë* e dollapë për mbajtjen e ushqimeve, *musëndra* për mbajtjen e rrobave. Për tu përmendur janë odat e pritjes që dallohen për bukurinë e tyre, për muret e brendëshme të patinuara e të lyera me gëlqere, për dyert, dyshemetë, *nimet*, shkallët prej druri të punuara aq bukur prej druri të zgjedhur. Arti i punimit të drurit duket sidomos tek tavanet të dekoruara me forma të ndyshme gjeometrike dhe floreale si dhe rozetat në qëndër në forma rrethore apo gjashtekëndore të punuara me shume shije. Shumica e ketyre punimeve janë punur nga tavanxhinjtë e talentuar vendas. Në përgjithësi banesat përpara kanë pasur obore të rrethuara me *avlli* e porta të rënda druri dy kanatëshe e me qemere e që mbylleshin me hekur apo lloze druri. Para tyre ishin ndërtuar sofate guri nga të dy anët e portës për të ndenjur. Në oborre në një vend të caktuar ish ndërtuar furra e bukës. Në fund të oborrit ndodheshin banjat me kanalizime të mbyllura si dhe *kotecët* e pulave. Pra çdo gjë ka qënë e parashikuar në menyrë të atille që tu shërbente sa më mirë nevojave të banorëve. Brenda territorit të fshatit Bënjë, ndodhen disa objekte “Monumente Kulture” të kategorisë së I-rë si : Shpella e Bënjës, e cila ndodhet mbi Urën e Katiut që i përket fundit të mijëvjeçarit të III-të p. e. sonë. Ura e Katiut, e cila ndodhet dy km në lindje të fshatit Bënjë. Ura është me dy harqe, me kurriz me theksim horizontal, e ndërtuar në fillim të shekullit të XVIII. Ura e përroit të Bënjës, e ndërtuar me një hark të vetëm e tipit shigjetë, ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit të XVII. Mulliru i Drithit Bënjë, ndërtuar buzë lumit të Lengaricës, është nga mullinjtë më të vjetër dhe unikalë në tërë zonën që dallohet nga mënyra e shfrytëzimit shumë funksionale të energjisë së ujit, si dhe nga pikpamja funksionale dhe ndërtimore, ndërtuar në vitin 1878. Ky fshat, me të gjitha këto objekte, duke përfshirë dhe kanionet e famshme të Lengaricës dhe burimeve termale gjatë saj e bëjnë këtë zonë tërheqëse dhe atraktive për vizitorët e turistët e huaj e vendas.




Fig. 3, Pamja Panoramike e luginës së Bënjës. Pas kodrës menjëherë ndodhen Banjat me ujrata termale dhe Ura e Katiut.



Fig. 4, Foto krahasuese e vitit 1938 dhe 2026 (Gjysma e Ansamblit u dogj prej Nazisteve në Luftën e II Botërore)



Fig. 5, Pozicioni dominues i Kishës së Shën Mërisë në hyrje të ansamblit dhe qeparisave i japin një unitet atij pasi kemi përdorimin e një materiali dhe të të njëjtës teknikë.



Fig. 6, Pamja e ansamblit nga hyrja për në fshat. Harmonizimi i tij me terrenin përreth.

2. Vlerat e Ansamblit Arkitektonik

Nga vizitat në terren u dokumentua dhe analizua në këtë fazë, disa nga ndërtimet më karakteristike të ansamblit për të kuptuar dhe karakterin e tyre, tipologjitë dhe karakteristikat hapësinore dhe teknike. Ansambli arkitektonik përfshin banesat, krojet e fshatit në veri të tij, kalldrëmi historik brenda fshatit si dhe atë që lidhte Bënjën me luginën e lumit Langaricë i cili përfundon në ditët e sotme pak më i zgjatur nga Ura mbi përroin e Bënjës, urë që gëzon statusin Monument Kulture i Kategorisë së Parë. Në pjesën e kalldrëmit përfshihet dhe muret krah tij që janë pjesë e ndarjes së parcelave karakteristike. Pjesë e ansamblit janë dhe lëmenjtë karakteristike.




Fig. 7. Harte e Ansamblit Arkitektonik të Bënjës me Objektet e Shënuara se cilat janë tashmë Mon. Kat. I , cilat propozohen si Mon. Kat. I dhe II si dhe rrugët me kalldrëm brenda në Ansambel si dhe ajo që lidh fshatin me luginën.

SHTOJCE FOTOGRAFIKE – TEKNIKE

PASAPORTË MONUMENTI

EMËRTIMI (i hollësishëm sipas gjinisë)

Banese e familjes Prifti.

ADRESA (Qarku qyteti, fshati, lagja, rruga, numri)

Qarku GJIROKASTËR, Bashkia Përmet, fshati Bënjë,

PRONËSIA (Shtetërore, private) Private

PËRDORIMI I SOTËM Banesë e braktisur

FILLESTAR Banesë

I MUNDSHËM Banesë, Hotel, Muze etj.

SHPALLJA MONUMENT (Data dhe institucioni propozues)

Propozim Projekti - 2026

KATEGORIA E MONUMENTIT (I, II) I – e parë

VLERAT E MONUMENTIT :

Banese e familjes Prifti daton në vitin **1868** dhe përfaqëson një nga shembujt më të arirë të ansambllit rural në fshatin Bënjë dhe më gjerë në krahinën e Përmetit. Banesa zhvillohet në tri kate me muraturë guri të zi ranor, karakteristike e gjithë ansambllit dhe e mbuluar me çati me rasa guri. Tipologjikisht kategorizohet si banesë me një krah i cili zhvillohet në jug dhe në dy katet e sipërme përbën *Odën*. Oda është dhe kthina më e madhe e cila arihet përmes një *Divani* apo *Hajati* qendror. Në fundin e Odës ndodhet *Musandra*, një dollap i murëzuar e i stilizuar në të cilën mbaheshin mbulesat dhe tesha të ndryshme. Tavanet janë druri dhe nuk i kanë rozetat.




Fig. 1. Pansja e Ansambllit Arkitektonik të fshatit dhe vendi i banesës në të.




Fig. 2. Pansja pertraktuale e Banesës nga kjo odhë dhe hyrja.


Kati perdhe / Ground Floor



Kati i Parë / First Floor



Kati i Dytë / Second Floor





Pamje e ndërtesës Prifti nga rruga.



Musandër e banesës Prifti



Pamje e nje hollesie tavani, Rozete.

BIBLIOGRAFI

- [1] Caka, E. C., & Duka, F. D. (Eds.). (1431). *Defteri i regjistrimit të Përmetit dhe Korçës i vitit 1431* (V. B. Buharaja, Trans.).
- [2] Saliu, S. (2011, January 1). *Hulumtime për Luginën e sipërme të Përmetit*.
- [3] Lole, DH. (2000, January 1). *Përmeti dhe trevat e tij deri në vitin 1912*.
- [4] Kola, V. K. (2002). *Bënja e Përmetit: monografi* (A. X. Xoxa & Y. A. Avxhi, Eds.).
- [5] Bodinaku, N. (1977). Të dhëna arkeologjike nga rrethi i Përmetit / Données archéologiques de la région de Përmeti. *Iliria*, 7(1),